



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

---

Numri i lëndës: 2021:068002

Datë: 15.07.2021

Numri i dokumentit: 01999494

**C. nr. 76/2021**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtarin Artan Abazi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A “KEDS”, me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson D. R., jurist nga Gjilani, kundër të paditurit Sh. Rr nga ..... me objekt kontesti për kompenzimin e dëmit material, vlera e kontestit prej 317.53 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, në prezencën e të autorizuarit të palës së paditur, e në mungesë të të paditurit, më datën 14.07.2021, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET në tërësi si e bazuar** kërkesëpadia e paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A “KEDS”, me seli në Prishtinë dhe **DETYROHET** i padituri Sh.Rr. nga ....., që paditëses, në emër të kompenzimit të dëmit material t’ia paguaj shumën prej 317.53 euro (treqind e shtatëmbëdhjetë euro e pesëdhjetë e tre cent), të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

**II. DETYROHET** i padituri, që të paditurës në emër të shpenzimeve të procedurës t’ia paguaj shumën prej 20.00 euro, në emër të taksës gjyqësore për paraqitjen e padisë, në afat prej 7 ditësh, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

**A r s y e t i m**

**1. rrjedha e procedures**

Paditësja Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A “KEDS”, me seli në Prishtinë, përmes të autorizuarit të saj D. R., jurist nga Gjilani, më datën 08.04.2021, në këtë gjykatë ka parashtruar padi, kundër të paditurit Sh. Rr. nga, për kompenzimin e dëmit material, me vlerë të kontestit prej 517.53 euro.

Meqenëse i padituri Sh.Rr., ka qenë i njoftuar me rregull për datën dhe orën e seancës përgaditore e cila është caktuar më datën 14.07.2021, në ora 11:10h, por që në seancë i njëjti nuk është paraqitur e as mungesën e tij paraprakisht nuk e ka arsyetuar, e duke e pasur parasysh edhe propozimin e të autorizuarit të paditëses, që seanca përgaditore të mbahet në mungesë të të paditurit, si dhe duke u bazuar në dispozitën e nenit 409, paragrafi 2, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (tutje LPK-së), ku përcaktohet se *“Po që se në seancën përgaditore nuk vjen i padituri që është thirrur rregullisht, shqyrtimi vazhdon të bëhet me palën paditëse të pranishme”*, gjykata vendosi që seanca përgaditore dhe ajo e shqyrtimit kryesor të mbahet në mungesë të të paditurit.

Gjykata, duke u bazuar në dispozitën e nenit 420, paragrafi 3, të LPK-së, ku përcaktohet se *“Gjykata mund të vendos që seanca për shqyrtim kryesor të çështjes të mbahet menjëherë pas asaj përgaditore”*, e duke i pasur parasysh shkresat e lëndës, ka konstatuar se kjo çështje juridike kontestimore nuk është e ndërlikuar dhe ka vendosur që menjëherë pas seancës përgaditore ta mbajë seancën për shqyrtim kryesor të çështjes.

## **2. Pretendimet e të autorizuarit të paditëses**

I autorizuari i palës paditëse juristi D. R., në seancën përgaditore dhe gjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se në fillim të seancës e njoftoj gjykatën se i padituri Sh. Rr., i ka bërë dy pagesa në shumë të përgjithshme prej 200.00 euro, në emër të rikthimit të humbjes, ashtu që i njëjti e ka bërë precizimin e kërkesëpadiës duke e zvogëluar të njëjtën nga shuma 517.53 euro, në shumën prej 317.53 euro dhe ka kërkuar që në emër të shkaktimit të dëmit material i padituri të detyrohet që t'a paguaj shumën prej 317.53 euro. I njëjti ka shtuar se kërkesëpadija e paditëses është në tërësi e bazuar si për nga baza juridike, poashtu edhe për nga lartësia e saj, e që sipas të autorizuarit të palës paditëse këto fakte vërtetohen në bazë të provave materiale të cilat i'u kanë bashkangjitur padisë, e të cilat prova materiale ka kërkuar nga gjykata që të administrohen në shqyrtimin kryesor, e pasë të gjitha këtyre i njëjti ka kërkuar nga gjykata që padia dhe kërkesëpadija e paditëses të aprovet në tërësi si e bazuar, ndërsa kamatën ligjore nuk e ka kërkuar, por që në emër të shpenzimeve të procedurës ka kërkuar nga gjykata që i padituri të detyrohet të paguaj vetëm shumën prej 20.00 euro, në emër të pagesës për taksën gjyqësore për paraqitjen e padisë.

## **3. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor**

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore në procedurën e provave i ka administruar këto prova materiale: Aktgjykimi me nr. P.nr. 257/2016, i datës 23.11.2018, të marrur nga Gjykata Themelore në Gjilan, Dega në Kamenicës i plotëfuqishëm me datën 27.12.2018, fatura me numër DGL16HP05179, e datës 18.05.2016, në emër të Sh. Rr., dhe transaksionet e konsumatorit me nr. DGL-41626, në emër të Sh. Rr., nga .....

Pasi që gjykata e bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, konform dispozitës së nenit 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (tutje LPK-së), erdhi në përfundim

se kërkesëpadia e paditëses është në tërësi e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi për këto arsye:

Gjykata ka konstatuar që në mes të palëve ndërgjyqëse lidhur me këtë çështje juridike kontestimore, nuk ishte kontestuese baza juridike e as lartësia e kërkesëpadisë së paditëses.

Në bazë të Aktgjykimit me nr. P.nr. 257/2016, i datës 23.11.2018, të marrur nga Gjykata Themelore në Gjiilan, Dega në Kamenicës i plotëfuqishëm me datën 27.12.2018, gjykata e vërtetoi faktin se i akuzuari Sh. Rr., tani i padituri është shpallur fajtor, për kryerjen e veprës penale, lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321, të KPRK-së, dhe të njëjtit i është shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 200 euro dhe dënim me burgim prej 60 ditëve, të cilat dënime nuk do të ekzekutohet nëse brenda një viti pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi i akuzuari, Sh. Rr. nuk kryen vepër tjetër penale.

Në bazë të faturës me numër DGL16HP05179, e datës 18.05.2016, në emër të Sh. Rr., gjykata e vërtetoi faktin se i padituri, për shfrytëzimin e energjisë elektrike, ka pasur për obligim që paditëses t'ia paguaj në emër të borxhit shumë prej 517.53 euro.

Në bazë të transaksioneve të konsumatorit me nr. DGL-41626, në emër të Sh. Rr., nga fshati ....., gjykata vërtetoi faktin se i padituri e ka shlyer – paguar një pjesë të shumës në emër të borxhit ndaj të paditëses “KEDS” me seli në Gjiilan, dhe atë i njëjti ka paguar shumë prej 200.00 euro.

#### **4. Baza juridike**

Andaj, duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 169 paragrafi 3, të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Ligji Nr.04/L-077, (tutje LMD-së), në të cilën përcaktohet se *“Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t'ia paguajë të dëmtuarit shumë përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit”*, ndërsa në dispozitën e nenin 136 paragrafi 1, të LMD-së, përcaktohet se *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*, e në rastin konkret gjykata, nga Aktgjykimi penal me nr. P.nr. 257/2016, të datës 23.11.2018, të Gjykatës Themelore në Gjiilan – Dega në Kamenicë, i cili është i plotëfuqishëm nga data 27.12.2018, ka konstatuar themelësinë e kërkesëpadisë së paditëses “KEDS”, Distrikti në Gjiilan, ngase i padituri Sh.Rr. nga provat e lartëcekura rezulton të jetë shkaktar i dëmit material nga periudha e pa vërtetuar e deri me datë 17.05.2016. Ndërsa lidhur me lartësinë e gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata me rastin e marrjes së vendimit u bazua në faturën me numër DGL16HP05179, të datës 18.05.2016, të lëshuar nga Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike “KEDS”, Distrikti në Gjiilan, nga e cila është konstatuar dëmi material i shkaktuar ndaj paditëses, nga ana e të paditurit, në lartësi prej 517.53 euro, por që në seancën e shqyrtimit kryesor në bazë të provës materiale të dorëzuar nga i autorizuari i paditëses dhe atë transaksionin e konsumatorit me nr. DGL-41626, në emër tani të paditurit Shaban Rrudhani, u vërtetua se i padituri e ka shlyer një pjesë të borxhit dhe atë në shumë prej 200.00 euro, ashtu që tani e tutje të njëjtit i ka mbetur për detyrim që t'a përmbushë edhe

pjesën tjetër në emër të borxhit ndaj paditëses dhe atë në shumë prej 317.53 euro, ashtu siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### **5. Vlerësimi përfundimtarë i gjykatës**

Duke i marrë parasysh provat materiale të lartëcekura dhe gjendjen faktike të vërtetuar si më lartë, gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret, pamëdyshme u vërtetua se padia dhe kërkesëpadia e paditëses “KEDS”, Distrikti në Gjilan, është në tërësi e bazuar si për nga baza poashtu edhe për nga lartësia e saj dhe e ka detyruar të paditurin Sh.Rr., nga ....., që paditëses “KEDS”, Distrikti në Gjilan, në emër të kompenzimit të dëmit material, t’ia paguaj shumë prej 317.53 euro. Faktin se kërkesëpadia e paditëses është në tërësi e bazuar për nga baza, gjykata e vërtetoi në bazë të Aktgjykimi penal me nr. P.nr. 257/2016, të datës 23.11.2018, të Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë, i cili është i plotfuqishëm nga data 27.12.2018, e që përmes këtij aktgjykimi u vërtetua edhe fakti se i padituri është përgjegjës për shkaktimin e dëmit material ndaj paditëses, e të cilën provë materiale gjykata me rastin e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore e mori për bazë dhe i’a fali besimin e plotë sa i përket bazueshmërisë së kërkesëpadiës së paditëses. Ndërsa sa i përket lartësisë së kërkesës së paditëses “KEDS”, Distrikti në Gjilan, respektivisht kërkesës për kompenzimin e dëmit në lartësi prej 317.53 euro, siç është konstatuar me lartë, këtë fakt gjykata e vërtetoi në bazë të faturës me numër DGL16HP05179, të datës 18.05.2016, e Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike “KEDS”, Distrikti në Gjilan, përkatsishtë faktin se i padituri Sh.Rr., e ka për obligim që ndaj paditëses t’a përmbush edhe pjesën tjetër të detyrimit në shumë prej 317.53 euro, gjykata vërtetoi në bazë të transacionit të konsumatorit me nr. DGL-41626, në emër tani të paditurit Sh. Rr., e të cilën provë materiale gjykata me rastin e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore, e mori për bazë dhe i’a fali besimin e plotë sa i përket lartësisë së kërkesëpadiës së paditëses, në vlerë prej 317.53 euro, aq sa edhe kërkohet me precizimin e kërkesëpadiës nga paditësja, e pas të gjitha këtyre, gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke e aprovuar në tërësi si të bazuar, padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses.

Sa i përket kamatës ligjore, gjykata nuk ka vendosur për një gjë të tillë, ngase i autorizuari i paditëses nuk e ka kërkuar fare dhe ka hequr dorë nga kamata ligjore.

#### **6. Shpenzimet e procedurës kontestimore**

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata duke u bazuar në nenin 452, të LPK-së, ka vendosur që t’a detyrojë të paditurin, që paditëses, t’ia paguaj vetëm shumë prej 20.00 euro, në emër të taksës gjyqësore për paraqitjen e padisë.

Nga të cekurat si më lartë, e duke u bazuar në dispozitën e nenit 136 paragrafi 1 dhe 169 paragrafi 3, të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, e lidhur me nenin 143, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË KAMENICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil**  
**C. nr. 76/2021, i datës 14.07.2021**

**G j y q t a r i**  
**Artan Abazi, d.v**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 7 ditësh, pas ditës së pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2021:068002  
Datë: 15.07.2021  
Numri i dokumentit: 01999494